# Nënkryetari i komunës për komunitete (NKKK) 2015

## Fakte kyçe:

- I mandatuar për t'i ndihmuar kryetarit të komunës duke i ofruar këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet;
- Obligativ në komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve joshumicë;
- Mund të emërohet edhe në ato komuna ku komunitetet joshumicë përbëjnë më pak e 10% me vendim të kuvendit të komunës;
- Duhet t'i përfaqësojë të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë;
- Kandidatin për NKKK e propozon kryetari i komunës dhe e miraton kuvendi i komunës;
- Dokumentet kryesore: Ligji për vetëqeverisjen lokale (nr. 03/L-040, 2008) neni 54; Udhëzimi administrativ 01/2014 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna; Termat e referencës për NKKK.

## Themelimi

Deri tani, pozita e NKKK është krijuar në 14 komuna**:

| | |
|---|---|
| Fushë Kosovë | Mitrovicë* |
| Graçanicë | Novobërdë |
| Kamenicë* | Obiliq* |
| Kllokot | Prizren |
| Leposaviq* | Shtërpcë |
| Lipjan* | Zubin Potok* |
| Mamushë | Zveçan* |

* Pozita e NKKK nuk është e obligueshme, por megjithatë është krijuar
** Në Dragash/Dragaš, kjo pozitë nuk është krijuar përkundër arritjes së pragut prej 10%

## NKKK-të sipas komunitetit




## NKKK-të sipas gjinisë




## Përqindja e NKKK-ve që i realizojnë detyrat themelore*

Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet




Mbështetja e kërkesave të komunitetet drejtuar trupave komunale




Realizimi i vizitave informuese tek komunitetet dhe/ose promovimi i aktiviteteve informuese të komunës




Siguron zbatim efektiv nga ana e ekzekutivit të komunës të projekteve /aktiviteteve/politikave/rregulloreve lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve



Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve




Promovimi i ndërtimit të besimit të ndërsjellë mes komuniteteve dhe insitucioneve komunale




Siguron që në buxhet të parashihen mjete të mjaftueshme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të merren parasysh nevojat dhe interesat e tyre




Po Jo

## Numri i detyrave themelore* të realizuara

* Detyra të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe të politikave që monitorohen rregullisht nga OSBE




osbe
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

# Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete (ZKKKK) 2015

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe qeverisjes dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE-ja e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto lista me informata kanë si qëllim t'ju ofrojnë akterëve përkatës komunalë dhe institucioneve të nivelit qendror tregues që mund t'u ndihmojnë për t'i identifikuar mangësitë në respektimin e kritereve ligjore dhe për ta përcjellë rritjen e pajtueshmërisë me ato kritere.

## Fakte kyçe:

- I mandatuar për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve dhe për të shërbyer si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në mbledhjet e kuvendit;
- Post obligativ në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë;
- Nuk mund të krijohet në mënyrë legjitime në komunat ku komunitetet joshumicë janë më pak se 10%;
- Postin e mban pjesëtari i komunitetit joshumicë i cili ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës;
- ZKKKK duhet t'i përfaqësojë të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë;
- ZKKKK ka qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese;
- Dokumentet kryesore: Ligji për vetëqeverisje lokale (nr. 03/L-040, 2008) neni 55; Udhëzuesit për ZKKKK

## Themelimi

Deri tani, posti i ZKKKK-së është krijuar në 10 komuna*:

| | |
|---|---|
| Dragash | Novobërdë |
| Fushë Kosovë | Pejë** |
| Kllokot | Prizren |
| Leposaviq*** | Shtërpcë |
| Mitrovicë e Veriut# | Zubin Potok# |

*Në Graçanicë, ky post nuk është krijuar ende përkundër përmbushjes së pragut prej 10%
**Posti është krijuar, por nuk lejohet me ligj
***ZKKKK i mëparshëm ka dhënë dorëheqje nga KK në korrik të vitit 2015. Posti ka qenë i zbrazët deri më 28 korrik 2016
# Ligjshmëria e krijimit të këtij posti është e paqartë për shkak se nuk është bërë regjistrimi i popullsisë

## ZKKKK-të sipas komunitetit




## ZKKKK-të sipas gjinisë




## Përqindja e ZKKKK-ve që i realizojnë detyrat themelore*

Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve

Adresimi i brengave dhe çështjeve që ndërlidhen me nevojat e komuniteteve në punimet dhe mbledhjet e kuvendit komunal

Shqyrtimi i ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre**




* Detyra të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe të politikave që monitorohen rregullisht nga OSBE
**Në raste të tilla, hapi i radhës për ZKKKK-në do të jetë që të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit në kuvendin e komunës. Nëse kuvendi nuk e rishqyrton aktin apo vendimin ose ZKKKK konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai e parashtron çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

Po Jo

## Funksionimi & Raportimi




Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**